

**LIGJI NR. 03/L-035**

**PËR POLICINË**

Në mbështetje të Kapitullit IV neni 65 pika 1, Kapitulli XI neni 128 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Kuvendi i Republikës së Kosovës,

Miraton:

**LIGJIN PËR POLICINË**

**KREU I  
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

**Neni 1  
Qëllimi**

Qëllimi i këtij Ligji është themelimi i Policisë së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme policisë), përshkrimi i autorizimeve dhe i detyrave të saj, si dhe autorizimeve dhe i detyrave të zyrtarëve policorë, përcaktimi i strukturës organizative dhe rregullimi i çështjeve të tjera lidhur me aktivitetet dhe veprimet e Policisë së Republikës së Kosovës.

**Neni 2  
Parimet udhëzuese**

2.1 Veprimet e Policisë së Republikës së Kosovës udhëhiqen nga parimet e mëposhtme:

- a) trajtimi i barabartë dhe i drejtë i të gjithë personave;
- b) respektimi i të drejtave të njeriut dhe lirive themelore;
- c) paanshmëria dhe neutraliteti lidhur me bindjet dhe pikëpamjet politike të personave;
- d) integriteti, ndershmëria dhe përgjegjësia në shërbimin publik;
- e) transparenca-ofrimi i informatave për qytetarët dhe të qenit të hapur ndaj publikut;
- f) legjitimiteti, përshtatshmëria dhe proporcionaliteti;
- g) përkushtimi ndaj punësimit, avancimit dhe caktimit të detyrave në mënyrë gjithëpërfshirëse, meritore dhe pa diskriminim, duke reflektuar karakterin shumetnik në Republikën e Kosovës dhe duke i njohur parimet e barazisë gjinore dhe të drejtat e njeriut të parapara në Kushtetutë.

2.2 Zyrtarët policorë ushtrojnë autorizimet e tyre dhe kryejnë detyrat në mënyrë të ligjshme, të bazuara në Kushtetutë, në ligjet e tjera në fuqi dhe në Kodin e Etikës të hartuar nga Policia e Republikës së Kosovës dhe të miratuar nga Ministria e Punëve të Brendshme.

2.3 Kodi i Etikës do të jetë në përputhje me parimet e lartpërmendura dhe me Kodin Evropian të Etikës Policore.

**Neni 3  
Përkufizimet**

Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë domethënie, si vijon:

- **“Bordi i Ankesave”**- nënkupton Bordin Policor të Ankesave;
- **“Ndihmësdrejtori i përgjithshëm”**- nënkupton çdo ndihmës të Drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Republikës së Kosovës;

- “**Stafi Civil**”- nënkupton pjesëtarët e policisë të cilët janë të punësuar për të kryer shërbime administrative apo mbështetëse por të cilët nuk kanë autorizime policore;
- “**Zëvendës drejtori i përgjithshëm**”- nënkupton Zëvendës Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Republikës së Kosovës;
- “**Komisioni Disiplinor**”- nënkupton Komisionin për Emërimet e Larta Policore dhe Disiplinë.
- “**Drejtori i përgjithshëm**”- nënkupton Drejtorin e përgjithshëm të Policisë së Republikës së Kosovës;
- “**Inspektorati**”- nënkupton Inspektoratin Policor të Republikës së Kosovës të themeluar me ligjin për Inspektoratin Policor;
- “**Policia Gjyqësore**”- nënkupton zyrtarin e policisë, i cili përpos detyrave thera policore, është i autorizuar për të kryer hetimet dhe detyra të ngjashme nën mbikëqyrjen e Prokurorit Publik;
- “**Objektivi i ligjshëm i Policisë**”- nënkupton synimin të cilin e ndjek Policia gjatë ushtrimit të funksioneve të saj, që është në pajtim me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe me ligjin në fuqi;
- “**Ministri**”- nënkupton Ministrin e Ministrisë së Punëve të Brendshme;
- “**Ministria**”- nënkupton Ministrinë e Punëve të Brendshme;
- “**Policia**”- dhe “Policia e Kosovës” nënkupton Policinë e Republikës së Kosovës të themeluar në bazë të këtij Ligji;
- “**Zyrtari Policor**”- nënkupton zyrtarin nën betim të Policisë së Republikës së Kosovës të cilit i është dhënë autoriteti për të ushtruar autorizime Policore në kryerjen e detyrave të tij/saj;
- “**Autorizimet Policore**”- nënkupton autorizimet e zyrtarit policor që të imponoj kontroll të arsyeshëm ndaj njerëzve dhe pronës brenda juridiksionit të tij/saj për mbrojtjen e rendit dhe sigurisë publike;
- “**Drejtori rajonal**”- nënkupton çdo drejtor rajonal të Policisë së Republikës së Kosovës, përfshirë edhe drejtorin e Policisë kufitare;
- “**Këshilli i Sigurisë**”- nënkupton Këshillin Komunal të Sigurisë Publike të themeluar në secilën komunë të Republikës së Kosovës ; dhe
- “**Komiteti për Siguri**”- nënkupton Komitetin Lokal të Sigurisë Publike të themeluar nga Drejtori i përgjithshëm në komunitetin lokal në kuadër të një komune të Republikës së Kosovës.

#### **Neni 4 Themelimi i Policisë**

- 4.1 Me anë të këtij ligji themelohet Policia e Republikës së Kosovës si shërbim publik në kuadër të fushëveprimit të Ministrisë së Punëve të Brendshme.
- 4.2 Policia është person juridik.
- 4.3 Policia do të veprojë nëpërmjet zinxhirit të unifikuar komandues në tërë Republikën e Kosovës.
- 4.4 Policia ka uniformën, flamurin dhe emblemën e vet të cilat aprovohen nga Qeveria me propozimin e Ministrit.

#### **Neni 5 Marrëdhëniet ndërmjet Policisë dhe Ministrisë**

5.1 Policia funksionon nën autoritetin e Ministrit të Punëve të Brendshme dhe nën kontrollin dhe mbikëqyrjen e Drejtorit të përgjithshëm të Policisë. Autoriteti i Ministrit nuk përfshinë menaxhimin operacional të Policisë. Drejtori i përgjithshëm i raporton dhe i përgjigjet drejtpërdrejt Ministrit për administrimin dhe menaxhimin e Policisë. Drejtori i përgjithshëm bashkëpunon me Ministrin dhe i ofron informata dhe raporte që ky mund t'i kërkojë me arsye.

5.2 Në fushën e rendit dhe të sigurisë publike, Ministri ka këto të drejta:

- a) t'i zhvillojë politikat dhe ta mbështesë përgatitjen dhe zbatimin e legjislacionit;
- b) ta mbikëqyrë koordinimin ndërmjet Policisë dhe autoriteteve të tjera publike lidhur me kontrollin e kalimit kufitar;
- c) ta mbikëqyrë bashkëpunimin ndërmjet Policisë dhe agjencive të tjera, organizatave ndërkombëtare përgjegjëse në fushën e rendit dhe të sigurisë publike;
- d) t'i zhvillojë dhe t'i zbatojë strategjitë për marrëdhëniet me publikun dhe marrëdhëniet me organet e tjera përgjegjëse në fushën e rendit dhe të sigurisë publike;
- e) të kryejë funksione të caktuara disiplinore lidhur me zyrtarët policorë, siç është përcaktuar më tutje në këtë Ligj;
- f) të mbledhë, të mbajë dhe të analizojë të dhëna statistikore dhe informata; dhe
- g) të kryej funksione që lidhen me përgatitjet për raste emergjente, siç është përcaktuar me këtë Ligj.

## **Neni 6**

### **Marrëdhëniet ndërmjet Policisë, Prokurorit Publik dhe Gjykatës**

6.1 Policia ekzekuton urdhrat dhe udhëzimet e lëshuara në mënyrë të ligjshme nga prokurori publik ose gjyqtari kompetent.

6.2 Policia bashkëpunon dhe i raporton Zyrës së prokurorit publik kompetent për informatat lidhur me akuzat për aktivitete të dyshimta kriminale, për të cilat policia është njoftuar në pajtim me ligjin e aplikueshëm.

## **Neni 7**

### **Bashkëpunimi me komunitetin**

7.1 Me qëllim të parandalimit dhe luftimit të krimit dhe për shtimin e sigurisë për të gjitha komunitetet në Republikën e Kosovës, Policia komunikon dhe bashkëpunon me autoritetet e qeverisë lokale, organizatat civile dhe me komunitetet lokale.

7.2 Policia bashkëpunon me komunitetin, ndërkaq komandanti i stacionit dhe përfaqësues të tjerë policorë marrin pjesë në Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi, të themeluar në secilën komunë.

7.3 Këshilli për Siguri është një organ këshillues i kryesuar nga kryetari i Komunës me anëtarë që janë përfaqësues të të gjitha komuniteteve përbrenda komunës.

7.4 Qëllimi i Këshillit të Sigurisë është që ta zhvillojë vetëdijesimin lidhur me natyrën e krimeve, parregullsitë dhe sjelljet e dhunshme në komunitetin lokal, t'i identifikojë brengat lidhur me sigurinë publike dhe t'i rekomandojë planet e veprimit, për t'i adresuar këto brenga me përpjekje bashkëpunuese të autoriteteve komunale, komuniteteve lokale dhe Policisë.

7.5 Drejtori i përgjithshëm është i autorizuar të themelojë Komitetin për Siguri Publike, si një organ këshillues, në kuadër të ndonjë zone të caktuar në çdo komunë që është në interesin më të mirë për një punë efektive të Policisë në bashkësi.

## **Neni 8**

### **Bashkëpunimi me institucionet qendrore dhe me ato lokale të qeverisjes**

8.1 Policia bashkëpunon me institucione të tjera të qeverisjes qendrore të Republikës së Kosovës që janë përgjegjëse në fushën e sigurisë, bashkëpunim ky që do të rregullohet me akte ligjore të Qeverisë dhe me memorandume të mirëkuptimit, të miratuara nga Ministri.

8.2 Me kërkesë të institucioneve të qeverisjes qendrore ose lokale, Policia është e autorizuar t'u ofrojë ndihmë në kryerjen e detyrave publike, kur ka arsye për të besuar se siguria e personit ose e personave që kryejnë detyra publike mund të rrezikohet për shkak të rezistimit të mundshëm ndaj veprimeve të tyre.

## **Neni 9 Bashkëpunimi ndërkombëtar**

9.1 Policia bashkëpunon me organizatat policore ndërkombëtare dhe me institucionet e tjera të huaja, në bazë të ligjit në fuqi ose sipas marrëveshjes ndërkombëtare, nëse shteti i Kosovës është nënshkruar i saj.

9.2 Policia mund të dërgojë zyrtarë policorë në shërbim të përkohshëm në një organizatë tjetër policore ndërkombëtare me qëllim të kryerjes së detyrave policore jashtë vendit, në përputhje me ligjin në fuqi ose në bazë të marrëveshjes ndërkombëtare nëse shteti i Kosovës është nënshkruar i saj.

## **KREU II DETYRAT DHE AUTORIZIMET E POLICISË**

### **Neni 10 Detyrat dhe autorizimet e përgjithshme të Policisë**

10.1 Detyrat e përgjithshme të Policisë janë :

- a) ta mbrojnë jetën, sigurinë dhe pronën e të gjithë personave;
- b) t'i mbrojnë të drejtat dhe liritë themelore të të gjithë personave;
- c) ta parandalojnë rrezikun ndaj qytetarëve dhe ta mbajnë rendin dhe sigurinë publike;
- d) t'i parandalojnë dhe t'i zbulojnë veprat penale;
- e) t'i hetojnë veprat penale;
- f) të ofrojë mbikëqyrje dhe kontroll për sigurinë në komunikacion;
- g) të ofrojë mbikëqyrje dhe kontroll të kufijve;
- h) të ofrojë ndihmë gjatë fatkeqësive natyrore dhe në raste të tjera emergjente; dhe
- i) të kryejnë detyra të tjera të parapara me ligjin në fuqi;

10.2 Çdo Zyrtar Policor i ka atributet e Policisë Gjyqësore, në përputhje me Kodin e Procedurës Penale dhe me ligjet e tjera;

### **Neni 11 Autorizimet policore**

11.1 Gjatë kryerjes së detyrave policore, zyrtari policor ka autorizim të ushtrojë kontroll të arsyeshëm mbi njerëzit dhe pronën në kuadër të kompetencave dhe autorizimeve të tij apo të saj, të japë dhe të zbatojë urdhra dhe instruksione të ligjshme për anëtarët e shoqërisë në përgjithësi, për t'i arritur objektivat ligjorë të Policisë.

11.2 Autorizimet e cekura në këtë Ligj përcaktojnë autorizimet e përgjithshme dhe kufizimet e zyrtarit policor në kryerjen e detyrave të tij lidhur me parandalimin e rrezikut dhe mbajtjen e rendit dhe të sigurisë publike. Autorizimet dhe kufizimet e Zyrtarit Policor gjatë ushtrimit të detyrave përkitazi me hetimet penale, në mënyrë të përgjithshme, janë përcaktuar në ligjet e tjera, duke i përfshirë, por jo duke u kufizuar, në Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

11.3 Gjatë ushtrimit të detyrave të tyre, zyrtarët policorë të Policisë kufitare, kanë autorizim të patrollojnë kufirin, ta kontrollojnë trafikun ndërkufitarë, t'i ekzaminojnë dokumentet për kalimin e kufirit, të hyjnë në pronën private në zonën kufitare, përjashtimisht ata nuk mund të hyjnë në banesa private, por mund të hyjnë në stacione hekurudhore, aeroporte, trena dhe në aeroplanë. Policia mund të kërkojë të njihet me pronarin e pronës përgjatë kufirit, të ketë rrugë apo shteg përgjatë vijës kufitare dhe porta në murin rrethues për t'u mundësuar qasje zyrtarëve policorë gjatë patrullimit.

11.4 Policia është e autorizuar dhe ka për detyrë të ndërmarrë masa të nevojshme për t'i mbrojtur personat që mund t'i nënshtrohen çfarëdo kërcënimi, apo akti diskriminues, armiqësi ose dhunë lidhur me identitetin e tyre kombëtar, etnik, kulturor, gjuhësor dhe fetar.

11.5 Policia ofron siguri dhe mbrojtje për vendet e trashëgimisë fetare dhe kulturore nëpër Republikën e Kosovës.

## **Neni 12**

### **Përshtatshmëria dhe proporcionaliteti**

12.1 Zyrtari policor zbaton parimet e përshtatshmërisë dhe proporcionalitetit si një kufizim në ushtrimin e autorizimeve policore.

12.2 Kur ndërmerr masa parandaluese për ta kufizuar lirinë e personit, zyrtari policor duhet ta ketë parasysh maturinë, shkallën e rrezikut dhe seriozitetin e kryerjes së veprës penale në atë situatë, për ta përcaktuar shkallën e kufizimit të lirisë së personit.

12.3 Autorizimet e Policisë ushtrohen vetëm atëherë kur është e domosdoshme, dhe vetëm deri në atë nivel që nevojitet për t'i arritur objektivat ligjorë të Policisë me pasoja sa më pak të dëmshme dhe për kohë sa më të shkurtër të mundshme.

## **Neni 13**

### **Detyra e zyrtarit policor për t'i zbatuar urdhrat e ligjshëm dhe për t'i refuzuar urdhrat e paligjshëm**

13.1 Zyrtari policor ka për detyrë t'i ushtrojë autorizimet policore në përputhje me urdhrat e dhëna në mënyrë të drejtë nga mbikëqyrësi.

13.2 Zyrtari policor ka për detyrë t'i refuzojë urdhrat të cilët janë qartësisht të paligjshëm dhe të raportojë për ta, pa u frikësuar nga ndëshkimi.

13.3 Zyrtari policor nuk do të shkaktojë, nxisë, mbështesë ose tolerojë asnjë akt të torturës, degradimit ose trajtimit çnjerëzor në çfarëdo rrethanash, ndërsa asnjë rrethanë e jashtëzakonshme apo urdhër i lëshuar nuk do ta arsyetojë veprimin e tillë.

## **Neni 14**

### **Prezantimi i zyrtarit policor**

14.1 Para se t'i ushtrojë autorizimet policore, zyrtari policor do t'i njoftojë personat lidhur me statusin e tij/saj si zyrtar policor dhe, nëse nuk është në uniformë, do të prezantojë veten duke treguar kartelën e identifikimit ose shenjën e policisë.

14.2 Zyrtari policor do të prezantohet më vonë në rastet kur vihet në rrezik jeta, prona ose arritja e objektivave legjitime të Policisë.

## **Neni 15**

### **Pranimi i informatave për veprat penale dhe shkeljet e tjera të ligjit**

15.1 Zyrtari policor ka për detyrë t'i pranojë informatat e ofruara nga personat lidhur me kryerjen e ndonjë vepre penale ose me shkeljet e tjera të ligjit që janë relevante për punën dhe kompetencat e Policisë.

15.2 Kur Policia konstaton se vepra e raportuar nuk është vepër penale apo është vepër penale e cila ndiqet në bazë të padisë private, zyrtari policor duhet ta informojë personin që ka raportuar dhe palën e dëmtuar nëse ekziston ajo.

15.3 Informatat për vepra penale dhe shkelje të tjera të ligjit duhet të përcillen në Zyrën e Prokurorit Publik kompetent brenda njëzet e katër orëve (24) orëve nga pranimi.

## **Neni 16**

### **Identifikimi i personave dhe i sendeve**

16.1 Zyrtari policor ka autorizim ta përcaktojë identitetin e personit tjetër atëherë kur ekziston dyshimi i arsyeshëm se personi:

- a) ka kryer, është duke kryer, ose do të kryejë veprë penale;
- b) paraqet rrezik për personat ose pronën, ose është duke shkaktuar shqetësim;
- c) gjendet në vend të ndaluar sipas ligjit në fuqi;
- d) personi gjendet në vend të ngjarjes, në zonë të kufizuar ose në kufi;
- e) duhet të arrestohet ose të paraburgoset;
- f) është i autorizuar të ndërmarrë një veprim të tillë në bazë të cilitdo ligj tjetër në fuqi.

16.2 Në pajtim me dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni, Zyrtari policor është i autorizuar ta ndalë personin, ta pyet për identitetin e tij dhe të kërkojë ndonjë dokument identifikimi me fotografi. Zyrtari policor do t'ia tregojë personit shkakun e identifikimit. Kur personi nuk bashkëpunon dhe masat e tjera dështojnë për ta përcaktuar identitetin e tij, zyrtari policor mund ta marrë personin në mbajtje, duke i zbatuar procedurat e parapara me ligjin në fuqi, për ta vërtetuar identitetin e tij.

16.3 Ndalimi zgjatë vetëm aq kohë sa është e domosdoshme për t'u kryer identifikimi, por jo më gjatë se gjashtë orë. Zyrtari policor do ta përpilojë raportin për procedurën e identifikimit dhe një kopje të tij do t'ia japë presonit që është në mbajtje.

16.4 Zyrtari policor është i autorizuar ta vërtetojë ose ta përcaktojë identitetin e një sendi. Ky autorizim do të ushtrohet kur është e domosdoshme të përcaktohet vlera e një sendi, karakteristikat, pronësia ose për ta përcaktuar lidhjen e sendit me personin, ngjarjen ose me veprimin. Policia është e autorizuar ta publikojë fotografinë, skicën, regjistrimin ose përshkrimin e sendit, nëse ekziston bindje e arsyeshme se ky veprim do të ndihmojë në përcaktimin e identifikimit të sendit.

## **Neni 17** **Thirrjet e Policisë**

17.1 Zyrtari policor është i autorizuar ta thërrasë personin për të dhënë informacione nëse ka arsye të bazuar se personi i caktuar ka informacione të rëndësishme për arritjen e objektivave legjitimë të Policisë. Përgjigjja ndaj një ftese të tillë është vullnetare nga personi që e pranon ftesën.

17.2 Zyrtari policor është i autorizuar që ta thërrasë gojarisht personin e caktuar për intervistë në Polici, nëse ekziston arsye e bazuar se ai ka informacione të rëndësishme për arritjen e objektivave legjitime të Policisë.

17.3 Zyrtari policor duhet ta njoftojë personin lidhur me arsyen e thirrjes dhe, nëse personi pajtohet, zyrtari policor e shoqëron atë për në stacionin policor. Në raste urgjente, kur vonesa shkaktën rrezik ose janë thirrur shumë njerëz, atëherë thirrja mund të publikohet në mediat publike. Përgjigjja ndaj thirrjeve të tilla është vullnetare nga personi i thirrur.

17.4 Zyrtari policor është i autorizuar që me shkrim ta thërrasë personin e caktuar për intervistë në Polici, nëse ekziston arsyeja e bazuar se personi ka informacione të rëndësishme për arritjen e objektivave legjitime të Policisë. Fletëthirrja do të përmbajë titullin, adresën dhe vendin e organit policor që bën kërkesë për prezencën e personit, arsyen për thirrje, vendin dhe kohën ku duhet të paraqitet personi i thirrur.

17.5 Intervista policore për të miturit zhvillohet vetëm atëherë kur prindi ose kujdestari ka nënshkruar fletëthirrjen dhe e ka miratuar atë dhe vetëm në praninë e prindit ose të kujdestarit. Përgjigjja ndaj fletëthirrjes është vullnetare nga personi i thirrur.

17.6 Nëse personi i caktuar i përgjigjet thirrjes së Policisë për intervistë, por nuk jep asnjë informacion lidhur me intervistën, atëherë ky person nuk do të thirret përsëri për intervistë policore për të njëjtën çështje. Përgjigjet, me kërkesën e prokurorit publik ose të gjyqtarit dhe në pajtim me ligjin në fuqi, ai mund të thirret sërish.

17.7 Zyrtari policor lëshon fletëthirrje që personi i kërkuar të paraqitet për intervistë policore vetëm gjatë orarit ditor të punës, me përjashtim kur vonesa e thirrjes paraqet rrezik për personin, pronën, ose për arritjen e objektivave legjitime të Policisë.

17.8 Vetëm sipas urdhrat të gjykatës dhe vetëm në pajtim me ligjin e aplikueshëm, Zyrtari policor mund ta përdorë forcën për ta mbajtur personin e thirrur dhe për ta sjellë në stacionin policor ose në ndonjë vend tjetër. Nëse përdoret forca gjatë procesit të thirrjes, personi i thirrur informohet në gjuhën të cilën ai/ajo e kupton, se ka të drejtë të heshtë, ta konsultojë avokatin dhe ta kontaktoj një person familjar apo ndonjë person tjetër të besueshëm, siç parashihet në Kodin e Procedurës Penale.

### **Neni 18** **Kufizimi i përkohshëm i lirisë së lëvizjes**

18.1 Zyrtari policor është i autorizuar që përkohësisht t'ia kufizojë lirinë e lëvizjes personit në një zonë të caktuar ose ta orientojë lëvizjen e tij në një zonë tjetër, me qëllim që të sigurohet zona e caktuar për t'i arritur objektivat legjitimë të Policisë apo për t'i mbrojtur personat nga rreziku i përkohshëm.

18.2 Objektivat legjitime të Policisë përfshijnë, por nuk kufizohen në mbrojtjen e personave nga fatkeqësitë, epidemitë, dhe rastet e tjera të rrezikut të pashmangshëm.

18.3 Kufizimi i përkohshëm i lirisë së lëvizjes të personit përfundon menjëherë pasi të arrihen objektivat legjitime të Policisë lidhur me kufizimin e përkohshëm.

### **Neni 19** **Vërejtjet dhe urdhrat**

19.1 Zyrtari policor është i autorizuar të japë vërejtje gojore, me shkrim, vizuale ose vërejtje të tjera ndaj çdo personi që paraqet rrezik për sigurinë personale a publike, paraqet rrezik për pronën private apo publike, prish rendin dhe qetësinë publike, paraqet rrezik për sigurinë në komunikacion ose ekziston dyshimi i bazuar se është duke kryer apo duke u përgatitur për të kryer një vepër penale ose është duke e detyruar personin tjetër të kryejë vepër penale.

19.2 Zyrtari policor është i autorizuar t'u japë urdhra personave të tillë në mënyrë që t'i ndalojë veprimet e tyre ose të ndërmarrë veprime të tjera të cilat zyrtari policor i konsideron të arsyeshme.

19.3 Vërejtjet dhe urdhrat mund të jepen me qëllim të arritjes së objektivave legjitime të Policisë duke përfshirë por jo duke u kufizuar vetëm në kushtet e parapara në nenin 11 të këtij Ligji

### **Neni 20** **Ndalimi i përkohshëm policor**

20.1 Zyrtari policor është i autorizuar ta ndalojë përkohësisht personin atëherë kur është e nevojshme:

- a) ta mbrojë personin nga rreziku dhe dëmi, veçanërisht kur personi s'ka mundësi për t'u mbrojtur; apo
- b) ta identifikojë personin ose t'i kufizojë lëvizjet e tij, siç autorizohet me ligj, kur personi është jo bashkëpunues ndaj masave më të lehta;

20.2 Ndalimi i përkohshëm policor zgjatë aq sa është e nevojshme që të arrihen objektivat legjitime të Policisë, por jo më gjatë se gjashtë (6) orë, përjashtimisht në rastet kur personi është ende në gjendje të pamundësisë për t'u mbrojtur, por jo edhe më gjatë se gjashtë (6) orë të tjera.

20.3 Personi nën ndalim të përkohshëm policor në pajtim me këtë nen nuk mbahet së bashku me të burgosurit, personat e arrestuar dhe të paraburgosurit e tjerë, me personat e gjinisë së kundërt dhe me persona të mitur përveç nëse vetë janë të mitur.

20.4 Personi nën ndalim të përkohshëm informohet lidhur me arsyet e mbajtjes, dhe i jepet mundësia ta lajmërojë ndonjë anëtar të familjes, institucionin përkatës ose personin tjetër të besueshëm.

20.5 Nëse personi në mbajtje është i paaftë për të vepruar, zyrtari policor përpiqet që ta njoftojë një anëtar të familjes ose ndonjë person tjetër të besueshëm, përveç nëse një gjë e tillë do të ishte në dëm të personit në mbajtje.

## **Neni 21**

### **Konfiskimi i përkohshëm i sendeve**

21.1 Zyrtari policor është i autorizuar që përkohësisht ta konfiskojë një send me qëllim që ta parandalojë rrezikun e menjëhershëm ndaj personave apo pronës, për ta mbrojtur pronarin apo poseduesin e ligjshëm nga humbja ose dëmtimi i sendit, apo në përputhje me ligjin në fuqi, ta mbajë në vend të sigurt, përdërisa personi të mbahet në paraburgim. Nëse dihet, pronari ose poseduesi i ligjshëm i sendit, do të informohet për arsyen e konfiskimit të përkohshëm dhe do t'i jepet vërtetimi përkatës.

21.2 Sendin e konfiskuar Policia e mban vetëm aq kohë sa është e nevojshme për t'i arritur objektivat ligjorë të saj, por jo më gjatë se dhjetë ditë, të cilin pastaj i'a kthen pronarit ose poseduesit të ligjshëm sa më shpejtë që të jetë e mundur.

21.3 Kufizimet e parapara në Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Kosovës zbatohen përshtatshmërisht për konfiskim të përkohshëm në pajtim me këtë nen.

## **Neni 22**

### **Kontrolli parandalues**

22.1 Zyrtari policor është i autorizuar të kryej me iniciativë të tij/saj kontroll me qëllim të parandalimit të rrezikut të menjëhershëm ndaj sigurisë publike, jetës dhe pronës, kontroll parandalues të personave, objekteve, hapësirave dhe vendeve të caktuara, kur ekziston dyshimi i arsyeshëm që veprat e kryera mund të rrezikojnë jetën apo pronën.

22.2 Kontrolli parandalues, në kuptimin e këtij neni, zbatohet me qëllim të largimit të armëve, apo sendeve tjera që paraqesin rrezik të pashmangshëm për jetën ose pasurinë, apo të parandalojë aktivitetet të cilat paraqesin rrezik të pashmangshëm për jetën dhe pasurinë. Kontrolli mund të përfshijë përdorimin e mjeteve teknike dhe të tjera për të zbuluar eksploziv, materie kimike, biologjike apo materiale radioaktive.

22.3 Pas ushtrimit të kontrollit, Zyrtari Policor harton procesverbal përkatës dhe brenda 48 orëve të njëjtin ia dërgon prokurorit publik kompetent për vendin ku është kryer kontrolli. Një kopje e procesverbalit duhet ti jepet pronarit ose poseduesit të objektit apo personit të kontrolluar. Personat e kontrolluar nga Policia, kanë të drejtë të bëjnë ankesë në gjykatën kompetente, nëse e konsiderojnë kontrollimin e tyre nga Policia si të padrejtë a në kundërshtim me ligjin.

22.4 Kufizimet e parapara në nenin 245 të Kodit Përkohshëm të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, do të zbatohen përshtatshmërisht për kontroll të përkohshëm, në përputhje me këtë nen.

## **Neni 23**

### **Sigurimi dhe këqyrja vendit të ngjarjes të veprës penale apo aksidentit**

23.1 Zyrtari policor është i autorizuar ta sigurojë dhe ta këqyrë vendin e ngjarjes të veprës penale ose aksidentit, derisa të vijë organi përgjegjës, që të gjejë dhe të sigurojë dëshmi, të zbulojë kryesin e veprës penale dhe të mbledhë informacione lidhur me veprën penale ose aksidentin.

23.2 Me qëllim të mbrojtjes së viktimave të veprës penale apo të aksidentit, zyrtari policor është i autorizuar ta pengojë incizimin video-akustik në perimetrin e sigurisë të vendit të ngjarjes të veprës penale apo aksidentit.

## **Neni 24**

### **Vëzhgimi parandalues i vendit publik**

24.1 Policia është e autorizuar të bëjë vëzhgim parandalues të vendit publik, duke përdorur pajisje për incizime video-akustike dhe pajisje fotografike për t'i vëzhguar vendet publike ku në të kaluarën shpesh janë kryer vepra penale, apo ku ka arsye të bazuar të besohet se vëzhgimi publik do ta zvogëlonte rrezikun nga kryerja e veprave penale dhe do ta përmirësonte sigurinë publike në të ardhmen.

24.2 Policia është e autorizuar t'i përdorë incizimet video-akustike dhe fotografitë për të vëzhguar dhe mbledhur informacione në një tubim publik atëherë kur ka arsye të bazuar se tubimi publik mund t'i rrezikojë personat apo pronën.



24.3 Para se të ndërmerret vëzhgimi parandalues, në përputhje me këtë nen, Policia do ta informojë publikun për qëllimin dhe arsyen e ndërmarrjes së këtij aktiviteti, përveç nëse kjo mund ta pengoj qëllimin apo rezultatin e vëzhgimit.

24.4 Incizimet video dhe audio nga vëzhgimi parandalues do të mbahen jo me gjatë se pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e incizimit, përveç kur pas kontrollimit, verifikohet se incizimi përmban të dhëna për veprimtari kriminale. Mbajtja e këtyre të dhënave më gjatë se kjo periudhë bëhet vetëm në rastet e parapara me ligjin në fuqi.

## **Neni 25** **Përdorimi i forcës**

25.1 Zyrtari policor është i autorizuar ta përdorë forcën vetëm atëherë kur është e domosdoshme dhe vetëm deri në atë nivel që kërkohet për t'i arritur objektivat legjitime të Policisë.

25.2 Zyrtari policor mund ta përdorë forcën për ta mbrojtur jetën e personit, për ta parandaluar sulmin, kryerjen e veprës penale, arratisjen e kryesit të veprës apo atëherë kur masat e tjera nuk janë të suksesshme për arritjen e një objektiwi tjetër legjitim të Policisë.

25.3 Zyrtari policor vepron me maturinë e tij/saj për ta përcaktuar llojin e forcës më të përshtatshme dhe kufizimet në përdorimin e forcës. Zyrtari policor merr parasysh rrethanat specifike, natyrën e veprës penale, shkallën e rrezikut ndaj personave të tjerë që janë të pranishëm dhe gjendjen fizike, mentale dhe emocionale të personit ndaj të cilit përdoret forca.

25.4 Në rastet e përdorimit të forcës, zyrtari policor duhet të përpiqet ta minimizojë ndërhyrjen në të drejtat dhe liritë e personit dhe të minimizojë çfarëdo pasoje të dëmshme.

25.5 Përdorimi i forcës, si term që përdoret në këtë ligj, përfshin por nuk kufizohet vetëm në përdorimin e: forcës fizike, shufrës zyrtare, sprejit, mjeteve pranguese, mjeteve për ndalimin e automjeteve, qenit të policisë, mjeteve kimike për paaftësim të përkohshëm, kalit të policisë, armëve të zjarrit, topave të ujit, automjeteve dhe llojeve të veçanta të armëve dhe mjeteve shpërthyes.

## **Neni 26** **Përdorimi i armëve të zjarrit**

26.1 Zyrtari policor është i autorizuar të posedojë dhe ta mbajë armën zyrtare të zjarrit të lejuar nga Policia. Zyrtari policor është i autorizuar ta përdorë armën e zjarrit vetëm atëherë kur është absolutisht e domosdoshme dhe vetëm deri në atë nivel që kërkohet për ta arritur objektivin ligjor të Policisë, kur përdorimi i saj është në proporcion me shkallën e rrezikut dhe seriozitetin e veprës penale në atë situatë, dhe vetëm nëse konsiderohet se me përdorimin e mjeteve më të vogla të forcës nuk do të arrihen objektivat legjitime të Policisë. Zyrtari policor nuk do të përdorë armën e zjarrit, në ato rrethana, kur ekziston rrezik i lartë që të rrezikohet jeta e personave dhe e kalimtarëve të pafajshëm.

26.2 Zyrtari policor është i autorizuar ta përdorë armën e zjarrit kundër personit tjetër vetëm kur mjetet më pak ekstreme janë të pamjaftueshme që ta:

- a) mbrojtë jetën e vet ose jetën e të tjerëve nga sulmet e pashmangshme;
- b) parandalojë kryerjen e pashmangshme apo vazhdimësinë e veprës penale që shkakton rrezik të lartë për jetën;
- c) arrestojë personin i cili paraqet rrezik për jetën e të tjerëve dhe që u reziston urdhrave ligjorë të dhënë nga zyrtari policor; dhe
- d) parandalojë arratisjen e personit i cili paraqet rrezik të pashmangshëm për jetën e personave të tjerë dhe që u reziston urdhrave ligjorë të dhënë nga zyrtari policor.

26.3 Para se ta përdorë armën e zjarrit, zyrtari policor jep vërejtje gojore, prezanton vetën si zyrtar policor, duke urdhëruar personin që të ndalet, por edhe duke e paralajmëruar se do të shtie nëse ai/ajo nuk ndalet.

26.4 Si masë e veçantë në rrethana urgjente, zyrtari policor mund të mos e bëjë paralajmërimin në rast se një veprim i tillë e rrezikon zyrtarin policor ose personat e tjerë nga një rrezik serioz i pashmangshëm.

26.5 Zyrtari policor është i autorizuar ta përdorë armën e zjarrit kundër kafshëve, kur ato paraqesin rrezik për shëndetin dhe sigurinë e cilitdo person ose për shkak të rrezikut nga sulmi apo rreziku nga sëmundjet e tyre ngjithëse. Zyrtari policor po ashtu është i autorizuar ta përdorë armën e zjarrit kundër kafshëve që janë seriozisht të sëmura a të lënduara, atëherë kur veterinari ose ndonjë person tjetër nuk është në gjendje t'i ndërmarrë masat e nevojshme.

#### **Neni 27**

#### **Përdorimi i pasurisë së personave të tretë në rrethana urgjente**

27.1 Zyrtari policor është i autorizuar që përkohësisht ta marrë apo ta përdorë çfarëdo prone, duke përfshirë, por jo duke u kufizuar në mjetet e transportit, të komunikimit ose të mbrojtjes, që janë në posedim të kalimtarët të rastit, mirëpo vetëm atëherë kur është e domosdoshme që të parandalohet rreziku i pashmangshëm për personat ose pronën apo për të arritur një objektiv tjetër policor urgjent që kërkon veprim të menjëhershëm.

27.2 Prona që merret në përdorim duhet t'i kthehet personit nga cili është marrë menjëherë pasi të mos jetë më e nevojshme që të arrihen objektivat urgjentë policorë për çka edhe është marrë, por në asnjë rast jo më gjatë se 24 orë pas marrjes. Policia do ta kompensojë pronarin apo poseduesin për çdo shpenzim apo dëm që i është shkaktuar pronës gjatë përdorimit të saj.

#### **Neni 28**

#### **Burimet e besueshme të informatave**

28.1 Zyrtari policor do t'i pranojë dhe vlerësojë të gjitha informatat e marra nga individët anonimë që janë relevante për kryerjen e detyrave policore dhe arritjen e objektivave legjitime të Policisë.

28.2 Zyrtari policor mund të krijojë marrëdhënie bashkëpunuese të besueshme me personat me qëllim që të marrë informata relevante që kanë të bëjnë me kryerjen e detyrave policore dhe arritjen e objektivave legjitime të Policisë.

28.3 Zyrtari policor do ta mbrojë besueshmërinë e marrëdhënieve të tilla bashkëpunuese dhe të informacioneve të marra përderisa obligimi ligjor për ta ruajtur besueshmërinë të jetë përmbushur. Zyrtari policor do ta mbajë sekret identitetin dhe rrethanat e tjerat të burimit të besueshëm, përveç nëse me kërkesën ligjore të lëshuar nga prokurori publik kompetent ose gjyqtari kërkohet zbulimi i identitetit.

#### **Neni 29**

#### **Njoftimi publik për shpërblimin**

29.1 Policia është e autorizuar të ofrojë shpërblime për dhënien e informatave relevante që shkojnë në dobi të kryerjes së detyrave policore dhe për arritjen e objektivave legjitime të Policisë. Ofertat e tilla për shpërblime do të shpallen publikisht në gazeta, radio, televizione ose në media të tjera përkatëse apo në mënyra të tjera.

29.2 Shpërblimi i tillë jepet vetëm nëse informatat e marra ende nuk janë në duart e Policisë dhe vetëm atëherë kur marrja e këtyre informatave shpie në arritjen e objektivave legjitime të Policisë, për çka edhe është marrë informata.

#### **Neni 30**

#### **Mbledhja, ruajtja, procedimi, analizimi, përdorimi dhe fshirja e të dhënave**

30.1 Policia është e autorizuar t'i mbledhë dhe t'i ruajë të dhënat personale, të dhënat mbi krimin dhe të dhënat e tjera. Të dhënat personale janë të dhëna që kanë të bëjnë me një person të identifikuar apo të identifikueshëm që përfshijnë, por nuk kufizohen në emër, datëlindje, vendin e lindjes dhe në vendbanimin. Të dhënat e krimit janë të dhëna që kanë të bëjnë me vepra të caktuara penale që përfshijnë, por nuk kufizohen në llojin e veprës penale, kohën dhe vendin e kryerjes së veprës, metodat dhe mënyrat e përdorura për kryerjen e veprës, çfarëdo lëndime të personave apo dëmin e pasurisë që është pasojë e veprës penale dhe motivin e saj.

30.2 Policia mbledh, ruan dhe përdor të dhënat personale në mënyrë të saktë në përputhje me ligjet në fuqi, instrumentet ndërkombëtare relevante dhe me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut me

qëllim të mbrojtjes së individëve nga çfarëdo shkelje e të drejtave të tyre ligjore lidhur me besueshmërinë apo të drejtën ligjore të jetës së tyre private.

30.3 Policia mbledh dhe ruan të dhënat personale dhe të dhënat e veprave penale vetëm për analiza dhe përdorim në mbrojtjen e rendit dhe të sigurisë publike, zbulimin dhe parandalimin e veprave penale, në identifikimin, vendndodhjen dhe në kapjen e kryesve të veprave penale dhe për arritjen e objektivave të tjera legjitime të Policisë.

30.4 Policia ruan të dhënat personale vetëm deri në atë masë kur ekziston arsyetimi i bazuar se ruajtja e informatave do të ndihmojë në arritjen e objektivave legjitimë të Policisë. Kufizimet e arsyeshme në llojin e informatave të ruajtura, në kohëzgjatjen e ruajtjes së të dhënave personale në regjistrat e Policisë dhe çështjet e tjera që kanë të bëjnë me mbledhjen, ruajtjen dhe përdorimin e të dhënave do të rregullohen me akte nënligjore të nxjerra në bazë të ligjit në fuqi dhe standardeve ndërkombëtare.

30.5 Policia nuk duhet të mbledhë dhe të ruajë informata dhe të dhëna personale për personat me qëllim të mirëmbajtjes së regjistrave që kanë të bëjnë me bindjet apo anëtarësimet politike, religjioze apo filozofike.

30.6 Zyrtari policor ka për detyrë ta ruajë besueshmërinë e të gjitha të dhënave personale dhe të dhënave të krimit të cilat ai apo ajo i ka marrë gjatë kryerjes së detyrave policore, përveç në ato raste kur lirimi i të dhënave autorizohet me ligj dhe është e nevojshme për të arritur objektivin legjitim të Policisë.

30.7 Policia siguron mbikëqyrje kompetente për sistemin e informatave ku regjistrat policorë mbahen me qëllim të mbrojtjes së të dhënave personale në pajtim me ligjet në fuqi që rregullojnë mbrojtjen e të dhënave personale.

30.8 Të dhënat numerike që kanë të bëjnë me veprat penale, kryesit e veprave, viktimat apo me kategori të tjera që lidhen me veprën penale apo me sigurinë, mund të përdoren për qëllime statistikore apo analitike nga Policia apo Ministria. Të dhënat e tilla do të jenë të mundshme për përdorim edhe nga autoritetet hulumtuese profesionale apo akademike.

30.9 Të dhënat personale mund t'u jepen edhe organizatave të huaja dhe atyre ndërkombëtare policore, atëherë kur kjo autorizohet nga Drejtori i përgjithshëm në bazë të ligjit në fuqi.

30.10 Policia siguron me kërkesën e ndonjë personi, çfarëdo të dhëna personale të ruajtur nga Policia lidhur me personin që bënë kërkesën, përveç nëse në ato raste dhënia e të dhënave mund t'i dëmtojë hetimet ose kur interesi i besueshmërisë nga personi tjetër ose publiku është më i rëndësishëm se interesi i zbulimit të personit që ka bërë kërkesën. Pas zbulimit se të dhënat personale të ruajtura në regjistrat janë jo të sakta, Policia do t'i korrigjojë apo largojë ato të dhëna personale.

### **KREU III ORGANIZIMI I POLICISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

#### **Neni 31 Organizimi i Policisë së Republikës së Kosovës**

31.1 Policia organizohet në nivel qendror dhe lokal. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë është niveli qendror përgjegjës për tërë Republikën e Kosovës. Niveli lokal përfshin Drejtoritë Rajonale të Policisë, përgjegjëse për rajonet e përbëra me komunat e caktuara, stacionet policore që janë përgjegjëse për policinë lokale në secilën komunë dhe nënstationet policore - përgjegjëse për policinë lokale brenda zonave të caktuara të një komune.

31.2 Juridiksioni territorial i secilës Drejtore Rajonale përcaktohet nga Drejtori i Përgjithshëm. Juridiksioni territorial i secilit stacion policor do të jetë brenda kufijve të komunës, ku është vendosur. Juridiksioni territorial i secilit nënstation policor përcaktohet nga Drejtori i Përgjithshëm. Po ashtu duhet të ketë edhe stacione të Policisë Kufitare nën juridiksionin qendror të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë.

31.3 Struktura e brendshme organizative e Policisë së Republikës së Kosovës propozohet nga Drejtori i Përgjithshëm dhe aprovohet nga Ministri. Drejtori i Përgjithshëm, me miratimin e Ministrit, mund të themelojë njësitë policore të përkohshme për të kryer detyra të veçanta.

## **Neni 32**

### **Drejtoria e Përgjithshme e Policisë**

32.1 Drejtoria e Përgjithshme e Policisë është nën udhëheqjen, kontrollin dhe mbikëqyrjen e Drejtorit të Përgjithshëm.

32.2 Drejtoria e Përgjithshme e Policisë ka këto detyra dhe përgjegjësi:

- a) ta përkrahë Drejtorin e Përgjithshëm në kryerjen e detyrave të tij/saj;
- b) ta mbikëqyrë efektivitetin e Drejtorive Rajonale të Policisë;
- c) ta menaxhojë, vëzhgojë, analizojë dhe vlerësojë situatën e tërësishme të sigurisë;
- d) t'i udhëheqë veprimet policore në rrethana të jashtëzakonshme ose urgjente;
- e) ta koordinojë zhvillimin dhe implementimin e strategjive për parandalimin dhe zvogëlimin e krimit, rivendosjen dhe mbajtjen e rendit dhe të sigurisë publike dhe për sigurimin dhe kontrollin e kufijve;
- f) t'i koordinojë funksionet administrative të Policisë, duke përfshirë, por jo duke u kufizuar në mirëmbajtjen e të dhënave të Policisë dhe sistemin e telekomunikimit, rekrutimit, trajnimit dhe të edukimit të personelit policor, menaxhimin e buxhetit dhe të çështjeve financiare, prokurimin dhe në menaxhimin e rasteve dhe objekteve policore;
- g) të bashkëpunojë me organizata ndërkombëtare dhe ta koordinojë implementimin e marrëveshjeve ndërkombëtare lidhur me aktivitetet policore; dhe
- h) të kryejë punë të tjera të parapara me ligj, rregulla ligjore, me instruksione apo urdhra.

32.3 Selia e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Republikës së Kosovës do të jetë e vendosur në Prishtinë.

## **Neni 33**

### **Drejtoria Rajonale të Policisë**

33.1 Në mënyrë që veprimet policore të menaxhohen me efektivitet, Policia e Republikës së Kosovës ndahet në rajone të cilat, kurdo që të jetë e mundshme, do të jenë të njëjta me kufijtë rajonalë të gjyqësisë.

33.2 Juridiksioni territorial i Drejtorisë Rajonale përcaktohet nga Drejtori i Përgjithshëm. Në përcaktimin e juridiksionit territorial të Drejtorive Rajonale, konsideratë do t'i jepet faktorëve siç janë, mirëpo jo të kufizuar në madhësinë e rajonit, numrin e banorëve, nivelin e krimit, pozitën gjeografike, ndërtesat e rëndësishme, rrugët dhe në infrastrukturën tjetër.

33.3 Secila Drejtori Rajonale e Policisë drejtohet nga një Drejtor Rajonal i Policisë. Secila Drejtori Rajonale përfshin, por nuk do të kufizohet vetëm në funksionet e mëposhtme:

- a) të kryejë detyra dhe funksione të përcaktuara me ligj, udhëzime ose urdhra të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë;
- b) të përkrahë dhe mbikëqyrë efektivitetet policore përbrenda rajonit ku shërben; dhe
- c) të koordinojë detyra të ndryshme që mund të caktohen nga Drejtoria e Përgjithshme, siç janë edukimi profesional dhe trajnimi për zyrtarët policorë dhe stafin ose punët administrative lidhur me financat, objektet dhe pajisjet.

## **Neni 34**

### **Stacionet Policore Lokale**

34.1 Stacionet Policore themelohen në secilën komunë, ndërsa juridiksioni territorial i stacionit policor është i njëjtë me kufijtë e komunës të përcaktuar me ligj.

34.2 Stacionet Policore kryejnë detyra policore në kuadër të juridiksionit të tyre brenda territorit komunal. Secilin stacion policor e udhëheq komandanti i stacionit.

34.3 Drejtori Rajonal mund t'ia propozojë për miratim Drejtorit të Përgjithshëm, themelimin e nënstacioneve policore, departamenteve dhe nën departamenteve në kuadër të çdo stacioni policor.

34.4 Përbërja etnike e zyrtarëve policorë të caktuar në kuadër të komunës, deri në nivelin e mundshëm, do ta përfaqësojë përbërjen etnike të popullatës të asaj komune.

34.5 Para ndërmarrjes së çdo veprimi nga forcat policore qendrore apo speciale në kuadër të juridiksionit territorial të stacionit policor, komandanti i stacionit do të informohet nga Drejtori i Përgjithshëm, Drejtori Rajonal i Policisë, apo nga zyrtarët e tjerë policorë që kryejnë veprime të veçanta, përveç nëse rrethanat operacionale kërkojnë ndryshe. Veprimet do të jenë në pajtim me procedurat standarde ndër-etnike të Policisë së Republikës së Kosovës.

#### **Neni 35**

#### **Stacionet Policore Kufitare**

Përveç Stacioneve Policore që gjenden në secilën komunë, themelohen edhe Stacionet Policore Kufitare nën autoritetin dhe juridiksionin e Drejtorisë Rajonale të Policisë Kufitare me qëllim të menaxhimit dhe kontrollimit të kufijve në përputhje me këtë Ligj, Ligjin mbi mbikëqyrjen dhe kontrollin e kufirit shtetëror dhe me ligjet e tjera të aplikueshme për kufijtë.

#### **Neni 36**

#### **Themelimi i Policisë Rezervë**

36.1 Drejtori i Përgjithshëm i Policisë, me aprovimin e Ministrit, themelon Policinë rezervë në mënyrë që ta ndihmojë Policinë në veprimet e veçanta të sigurisë. Policia rezervë përbëhet nga vullnetarët të cilët e nënshkruajnë kontratën me Policinë që të jenë anëtarë rezervë, dhe janë të kualifikuar dhe të trajnuar të kryejnë detyra policore.

36.2 Anëtarët e Policisë rezervë mund të përdoren nga Drejtori i Përgjithshëm me aprovimin e Ministrit, në kombinim me zyrtarët e rregullt policorë në rrethana të jashtëzakonshme ose urgjente, siç janë: rastet emergjente publike të rëndësishme, reagimi emergjent ndaj sulmeve terroriste, çrregullimet ose trazirat e mëdha të qytetarëve, reagimet emergjente ndaj rrezikut të shkaktuar nga fatkeqësitë natyrore.

### **KREU IV**

### **MENAXHMENTI I LARTË I POLICISË**

#### **Neni 37**

#### **Drejtori i Përgjithshëm i Policisë**

37.1 Komisioni për Emërime të Larta dhe Disiplinë në Polici i propozon Ministrit kandidatët për emërim në pozitën Drejtor i Përgjithshëm i Policisë, ndërkaq Ministri i rekomandon Kryeministrit kandidatët e mundshëm për këtë post. Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë e emëron Kryeministri, bazuar në propozimet e paraqitura nga Ministri.

37.2 Drejtori i Përgjithshëm emërohet për një periudhë tri (3) vjeçare, dhe mund të riemërohet në fund të kësaj periudhe edhe për pesë (5) vjet të tjerë pa procedura konkurruese. Një person mund të shërbejë si Drejtor i Përgjithshëm në përgjithësi jo më shumë se tetë vjet.

37.3 Kualifikimet e kandidatëve për pozitën e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm me, së paku pesë (5) vjet përvojë në punën policore me rritje të vazhdueshme të përgjegjësisë, së paku 3 vjet të shërbimit në menaxhmentin e lartë policor, diplomë nga një universitet i akredituar, dhe diplomim nga akademia trajnuese policore e Republikës së Kosovës apo me përfundim të ndonjë programi trajnues të barasvlershëm tek një institucion tjetër. Kandidati duhet të jetë në gjendje t'i përmbushë kualifikimet minimale për një zyrtar policor. Kandidatët i nënshtrohen një hetimi mbi të kaluarën e tyre, dhe nuk duhet të jenë shpallur fajtorë për ndonjë vepër penale.

37.4 Drejtori i Përgjithshëm është përgjegjës që të udhëheqë, kontrollojë dhe mbikëqyrë Policinë, të bëjë rekomandime buxhetore te Ministri në emër të Policisë dhe ta menaxhojë dhe shpërndajë buxhetin e Policisë në përputhje me caktimet dhe prioritetet e parapara nga Ministri.

#### **Neni 38**

#### **Zëvendës drejtori i Përgjithshëm dhe Ndihmësdrejtorët e përgjithshëm**

38.1 Zëvendësdrejtori i Përgjithshëm i Policisë dhe Ndhmës drejtorët e Përgjithshëm të Policisë emërohen nga Ministri bazuar në rekomandimet e Komisionit për Emërime të Larta dhe Disiplinë të Policisë, si rezultat i një procesi të rekrutimit dhe seleksionimit konkurrues transparent, siç është paraparë në ligjin në fuqi.

38.2 Zëvendësdrejtori i Përgjithshëm dhe secili Ndhmës drejtor i Përgjithshëm do të emërohet për një periudhë fillestare prej tre vjetësh dhe mund të riemërohet në fund të kësaj periudhe edhe për 5 vjet të tjerë pa procedurë konkurruese. Një person mund të shërbejë në përgjithësi jo më shumë se tetë vjet në cilëndo nga këto pozita: Zëvendësdrejtor i Përgjithshëm dhe Ndhmësdrejtor i Përgjithshëm.

38.3 Kualifikimet minimale të kandidatëve për pozitat e Zëvendësdrejtorit të Përgjithshëm dhe të Ndhmësdrejtorit të Përgjithshëm do të jenë të njëjta me ato për Drejtor të Përgjithshëm të parapara në paragrafin 3 të nenit 37 të këtij ligji.

38.4 Rolin dhe funksionet e Zëvendësdrejtorit të Përgjithshëm do të përcaktohen nga Drejtori i Përgjithshëm me miratim të Ministrit. Zëvendësdrejtori i Përgjithshëm ndihmon në përbushjen e funksioneve të Drejtorit të Përgjithshëm ashtu siç udhëzohet nga Drejtori i Përgjithshëm, dhe do t'i ushtrojë autorizimet dhe detyrat e Drejtorit të Përgjithshëm në mungesë të tij /saj apo në pamundësi të paraqitjes, ose me kërkesë të Drejtorit të Përgjithshëm.

38.5 Rolin dhe funksionet e secilit Ndhmësdrejtor të Përgjithshëm i përcakton Drejtori i Përgjithshëm me miratim të Ministrit.

### **Neni 39 Drejtori Rajonal i Policisë**

39.1 Drejtorët Rajonalë të Policisë emërohen nga Drejtori i Përgjithshëm nëpërmjet një procesi të brendshëm përzgjedhës, transparent dhe konkurrues.

39.2 Rolin dhe funksionet e Drejtorit Rajonal i përcakton Drejtori i Përgjithshëm.

39.3 Secili Drejtor Rajonal mbikëqyrë funksionet policore përbrenda rajonit të tij /saj dhe ushtron udhëheqje dhe kontroll të menjëhershëm mbi punëtorët e Policisë në Drejtorinë Rajonale.

### **Neni 40 Komandantët e stacionit**

40.1 Komandantët e stacioneve policore dhe komandantët e nënstacioneve emërohen nga Drejtori i Përgjithshëm me pjesëmarrje të Kuvendit Komunal në përputhje me dispozitat e këtij neni. Pjesëmarrja e Asamblesë Komunale në procesin e përzgjedhjes ka për qëllim ta theksojë rëndësinë e përgjegjësive të cilat Policia dhe zyrtarët policorë i kanë për t'iu përgjigjur nevojave dhe brengave të komunitetit lokal në lidhje me shërbimet policore.

40.2 Drejtori i Përgjithshëm paraqet në Kuvendin Komunal një listë me më së paku tre kandidatë për pozitën e Komandantit të Stacionit apo të Komandantit të nënstacionit.

40.3 Kuvendi Komunal radhitë kandidatët e propozuar dhe njofton Drejtorin e Përgjithshëm lidhur me radhitjen brenda 15 ditëve pas pranimi të listës nga Drejtori i Përgjithshëm. Brenda 15 ditëve pas pranimi të listës së radhitur, Drejtori i Përgjithshëm emëron Komandantin e Stacionit ose Komandantin e nënstacionit në mesin e kandidatëve, duke u dhënë konsideratën e duhur rekomandimeve të Kuvendit Komunal.

40.4 Nëse Kuvendi Komunal i refuzon të gjithë kandidatët e propozuar nga Drejtori i Përgjithshëm, atëherë Drejtori i Përgjithshëm i propozon tre kandidatë të rinj, ndërsa Kuvendi Komunal do t'i radhisë kandidatët e rinj dhe Drejtori i Përgjithshëm do ta emërojë kandidatin në mënyrë të ngjashme si në paragrafin 3 të këtij neni.

40.5 Nëse, pas raundit të dytë të kandidatëve, Kuvendi Komunal refuzon të gjithë kandidatët, Drejtori i Përgjithshëm emëron Komandantin e Stacionit apo të nënstacionit nga mesi i kandidatëve të propozuar nga dy raundet e mëparshme. Nëse Kuvendi Komunal nuk ka ndonjë rekomandim për ndonjërin nga

kandidatët e propozuar, Drejtori i Përgjithshëm emëron komandantin e stacionit apo të nënstacionit nga kandidatët e raundit të dytë.

40.6 Komandanti i Stacionit Policor dhe Komandanti i Nënstacionit policor mbikëqyrë funksionet policore përbrenda juridiksionit të tij /saj të caktuar dhe do të ushtrojë udhëheqje dhe kontroll të menjëhershme mbi të punësuarit e caktuar në Stacionin apo Nënstacionin Policor .

#### **Neni 41**

#### **Përzgjedhja e veçantë e Komandantëve të Stacionit**

41.1 Në komunat ku komuniteti serb është komuniteti më i madh etnik, Komandantët e Stacioneve Policore dhe Komandantët e nënstacioneve i përzgjedh Drejtori i Përgjithshëm me pjesëmarrjen e Kuvendit Komunal, në pajtim me dispozitat e këtij neni. Pjesëmarrja e Kuvendit Komunal në procesin e përzgjedhjes ka për qëllim ta theksojë rëndësinë e përgjegjësive që Policia dhe zyrtarët policorë kanë për t'iu përgjigjur nevojave dhe brengave të komunitetit lokal në lidhje me shërbimet policore.

41.2 Për ta filluar procesin e përzgjedhjes, Drejtori i Përgjithshëm do të kërkojë me shkrim nga Kuvendi Komunal i komunës, në të cilën gjendet Stacioni apo nënstacioni Policor, rekomandim të së paku dy kandidatëve për Komandant të Stacionit apo komandant të nënstacionit të cilët përmbushin të gjitha nevojat minimale për pozitën e paraparë me ligj. Kur Drejtori i Përgjithshëm parashton kërkesën, mund t'i ofrojë Kuvendit Komunal sugjerime për kandidatët që ata do t'i kenë parasysh gjatë shqyrtimit të tyre. Kuvendi Komunal do t'i rekomandojë së paku dy kandidatë të kualifikuar te Drejtori i Përgjithshëm brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga pranimi i kërkesës, dhe mund t'i radhisë ata sipas rekomandimit. Drejtori i Përgjithshëm në konsultim me Komandantin Rajonal përzgjedh njërin nga kandidatët e rekomanduar në afatin kohor prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve pas pranimit të rekomandimeve, duke marrë parasysh ndonjërin nga rekomandimet e përmendura. Kandidatët e zgjedhur më pastaj do të emërohen nga Ministria e Punëve të Brendshme pa vonesë, përveç nëse aplikohen dispozitat e më poshtme të paragrafit 3 të këtij neni.

41.3 Nëse asnjëri nga kandidatët e rekomanduar nuk është i pranueshëm për Ministrinë e Punëve të Brendshme, atëherë Drejtori i Përgjithshëm njofton Kuvendin Komunal dhe kërkon prej tij së paku dy rekomandime shtesë të kandidatëve që janë aktualisht zyrtar policorë dhe të cilët përmbushin kushtet minimale profesionale të parapara me këtë Ligj. Kuvendi Komunal rekomandon së paku dy kandidatë të kualifikuar te Drejtori i Përgjithshëm brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve pas pranimit të kërkesës, dhe do t'i radhitë ata sipas rekomandimit. Drejtori i Përgjithshëm, në konsultim me Komandantin Rajonal, përzgjedh njërin nga kandidatët e rekomanduar në afatin kohor prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve pas pranimit të rekomandimeve, duke marrë parasysh ndonjërin nga rekomandimet e përmendura. Kandidatët e zgjedhur pastaj emërohen pa vonesë nga Ministria e Punëve të Brendshme.

41.4 Nëse Kuvendi Komunal nuk i jep rekomandimet e kërkuara sipas këtij Neni pas pranimit të kërkesës me shkrim nga Drejtori i Përgjithshëm, atëherë Drejtori i Përgjithshëm është i autorizuar ta emërojë Komandantin e stacionit ose Komandantin e nënstacionit pa rekomandimin e Kuvendit Komunal, duke i dhënë konsideratë nevojave dhe brengave të komunitetit lokal lidhur me shërbimet policore. Drejtori i Përgjithshëm e lajmëron brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve me shkrim Kuvendin Komunal lidhur me emërimin.

41.5 Komandanti i Stacionit dhe komandanti i nënstacionit mbikëqyrë funksionet policore përbrenda juridiksionit të tij apo saj të caktuar dhe ushtron udhëheqje dhe kontroll të menjëhershëm mbi të punësuarit e caktuar në Stacionin apo nënstacionin e tij/saj policor .

#### **Neni 42**

#### **Komandantët e Stacioneve të Policisë Kufitare**

42.1 Komandantët e Stacioneve të Policisë Kufitare i emëron Drejtori i Përgjithshëm në përputhje me procesin e brendshëm të përzgjedhjes konkurruese, pa pjesëmarrjen e Kuvendit Komunal.

42.2 Secili Komandant i Stacionit të Policisë Kufitare mbikëqyrë funksionet policore përbrenda juridiksionit të vet dhe do të ushtrojë udhëheqje dhe kontroll të drejtpërdrejtë mbi të punësuarit e caktuar në Stacionin Policor kufitar të tij apo saj.

#### **Neni 43**

## **Largimi nga detyra i Drejtorit të Përgjithshëm, Zëvendës drejtorit dhe Ndhmës drejtorëve të Policisë**

43.1 Drejtori i Përgjithshëm, Zëvendës drejtori i Policisë dhe çdo Ndhmës drejtor i Policisë, mund të largohen nga detyra nga autoriteti që i ka emëruar para afatit të paraparë, për një nga arsyet e mëposhtme:

- a) me kërkesë të tij/saj;
- b) për shkak të paaftësisë për t'i kryer detyrat në afatin gjashtëmujor për shkaqe shëndetësore;
- c) për mosplotësimin e detyrave dhe përgjegjësive të caktuara;
- d) nëse ai/ajo është shpallur fajtor për shkelje të rëndë disiplinore; dhe
- e) nëse është dënuar për vepër penale me vendim gjyqësor të formës së prerë..

43.2 Pas shkarkimit, deri në momentin e emërimit të kandidatit të ri, do të caktohet ushtruesi i detyrës të cilin e emëron autoriteti i autorizuar për emërimin përkatës.

### **Neni 44 Procedurat disiplinore për Pozitat e Larta**

44.1 Akuzat për vepra të rënda apo të lehta disiplinore, që përfshijnë Drejtorin e Përgjithshëm, Zëvendës drejtorin e Përgjithshëm apo ndonjë Ndhmës drejtor të Përgjithshëm, hetohen nga Inspektorati Policor i Republikës së Kosovës në përputhje me procedurat e parapara në ligjin e aplikueshëm dhe në aktet nënligjore.

44.2 Inspektorati, për të gjeturat e veta, i raporton Komisionit për Emërime të Larta dhe Disiplinë në Polici i cili përcakton se a është kryer ndonjë vepër disiplinore dhe në rast se vepra disiplinore është kryer, duhet t'i rekomandojë Ministrin masat disiplinore që duhen të ndërmerren.

44.3 Ministri cakton masat disiplinore që duhen të ndërmerren, duke i marrë në konsideratë rekomandimet e Komisionit Disiplinor. Vendimi i Ministrin do të jetë vendim administrativ përfundimtar dhe mund t'i nënshtrohet shqyrtimit gjyqësor vetëm nga gjykata kompetente.

44.4 Kur shkelja disiplinore mund të rezultojë në vepër penale, Komisioni për Disipline dhe Ministri informojnë prokurorin kompetent për ta hetuar veprën penale.

### **Neni 45 Procedurat disiplinore për zyrtarët policorë dhe për të punësuarit e tjerë**

45.1 Akuzat për shkelje të rënda disiplinore, ku përfshihet zyrtari policor ose ndonjë punëtor tjetër i Policisë, përveç pozitave të larta, do t'i hetojë Inspektorati Policor i Republikës së Kosovës në përputhje me procedurat e përshkruara në ligjin në fuqi dhe në aktet nënligjore.

45.2 Inspektorati do t'i raportojë të gjeturat e veta te Komisioni për Emërime të Larta dhe Disiplinë në Polici i cili përcakton se a është kryer ndonjë vepër disiplinore dhe në rast se vepra disiplinore është kryer, duhet t'i rekomandojë Drejtorit të Përgjithshëm masat disiplinore që duhen të ndërmerren.

45.3 Drejtori i Përgjithshëm shqipton masën disiplinore, duke i marrë në konsideratë rekomandimet e Komisionit.

45.4 Kundër vendimit të Drejtorit të Përgjithshëm mund të bëhet ankesë te Ministri. Vendimi i Ministrin do të jetë vendim përfundimtar administrativ dhe mund t'i nënshtrohet shqyrtimit gjyqësor vetëm nga gjykata kompetente.

45.5 Shkeljet e lehta disiplinore, ku përfshihet zyrtari policor ose ndonjë punëtor tjetër i Policisë, përveç pozitave të larta, do t'i hetojë Njësiti i hetimeve të brendshme të Policisë në përputhje me procedurat e përshkruara në ligjin në fuqi dhe në aktet nënligjore. Njësiti i Standardeve Profesionale do t'i raportojë të gjeturat e veta te Komisioni i Brendshëm Disiplinor i Policisë, i cili do të përcaktojë se a është kryer ndonjë shkelje disiplinore dhe, në rastet kur shkelja disiplinore është kryer, shqipton masën disiplinore, duke marrë në konsideratë rekomandimet e Njësitet të hetimeve të brendshme.



45.6 Kundër vendimit të Komisionit të Brendshëm Disiplinor mund të ushtrohet ankesë në Komisionin për ankesa dhe shpërblime të Policisë. Vendimi i Komisionit të ankesave do të jetë vendim përfundimtar administrativ dhe mund t'i nënshtrohet shqyrtimit gjyqësor vetëm nga gjykata kompetente.

#### **Neni 46** **Shkeljet e rënda disiplinore**

Zyrtarët policorë dhe stafi civil bëjnë shkelje të rëndë disiplinore nëse ai/ajo kryen, tenton të kryejë, ndihmon ose nxit tjetrin ta kryejë njëri nga veprimet e mëposhtme:

- a) sjellja e rëndë diskredituese;
- b) mosbindja e rëndë;
- c) zbulimi i pavend dhe i rëndë i informatave;
- d) korrupsioni;
- e) shkelja e rëndë e autorizimit;
- f) përdorimi i pavend i armës;
- g) përdorimi i tepërt i forcës;
- h) dëmtimi i rëndë i pasurisë së Policisë;
- i) përdorimi i alkoolit ose i substancave të tjera intoksikuese;
- j) ngacmimi seksual gjatë shërbimit;
- k) veprimet diskriminuese në bazë të moshës, gjinisë, orientimit seksual si dhe përkatësisë etnike dhe fetare;
- l) keqpërdorimi dhe shfrytëzimi seksual i ndonjë personi;
- m) veprimtaria penale.

#### **Neni 47** **Shkeljet e lehta disiplinore**

Zyrtarët policorë dhe stafi civil bëjnë shkelje të lehtë disiplinore nëse ai/ajo kryen, tenton të kryejë, ndihmon ose nxit tjetrin ta kryejë njëri nga veprimet e mëposhtme:

- a) sjellja e lehtë diskredituese;
- b) mosbindja e lehtë;
- c) pakujdesia në detyrë;
- d) zbulimi i pavend dhe i lehtë i informatave;
- e) keqpërdorimi i lehtë i autorizimit; dhe
- f) dëmtimi i lehtë i pasurisë së Policisë ose mbajtja e papërshtatshme e uniformës dhe paraqitja e papërshtatshme personale.

#### **Neni 48** **Masat për shkeljet e rënda disiplinore**

Zyrtari policor ose stafi civil i Policisë i cili ka kryer shkelje të rëndë disiplinore i nënshtrohet njëri nga masat disiplinore:

- a) ndërprerjes së marrëdhënies së punës;
- b) uljes së gradës;
- c) largimit nga pozita komanduese;
- d) suspendimi pa pagesë prej 30 deri në 60 ditë dhe/ose
- e) ndalesa në pagë prej 20 deri 30 % e pagës mujore bruto deri dy muaj.

#### **Neni 49** **Masat për shkeljet e lehta disiplinore**

Zyrtari policor ose stafi civil i Policisë i cili ka kryer shkelje të lehtë disiplinore i nënshtrohet njëri nga masat disiplinore:

- a) vërejtje me gojë;
- b) vërejtje me shkrim;
- c) ndalesë në pagë që nuk është më e madhe se 20 % e pagës mujore bruto deri tre muaj;

- d) suspendimi pa pagesë deri 30 ditë dhe/ose
- e) transferim disiplinor.

## **KREU V**

### **PËRZGJEDHJA, TRAJNIMI, VLERËSIMI DHE DISIPLINA E ZYRTARËVE POLICORË**

#### **Neni 50**

##### **Standardet për Edukim dhe Trajnim të zyrtarëve policorë**

Drejtori i Përgjithshëm në koordinim me Ministrinë e Punëve të Brendshme do të jetë përgjegjës për përcaktimin dhe certifikimin e të gjitha standardeve minimale dhe programeve për kualifikim, punësim, rekrutim, selektim, trajnim obligues për periudhën provuese të punësimit dhe edukimin e vazhdueshëm të zyrtarëve të Policisë në harmoni me këtë Ligj dhe me sistemet e edukimit të përcaktuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

#### **Neni 51**

##### **Kualifikimet e përgjithshme për zyrtarët policorë**

Kualifikimet e zyrtarit policor përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në:

- a) shtetësi të Republikës së Kosovës;
- b) përfundimin e shkollimit të mesëm;
- c) gjendje të mirë fizike, mentale dhe emocionale;
- d) të mos jetë dënuar për ndonjë vepër penale; dhe
- e) histori të kaluar me karakter të mirë moral dhe sjellje etike.

#### **Neni 52**

##### **Procedurat e përzgjedhjes të zyrtarëve policorë**

Procedurat për përzgjedhjen dhe testimin e kandidatëve për pozitat e zyrtarëve policorë duhet të përfshijnë, por jo të kufizohen vetëm në testin për njohuri të përgjithshme, i cili përfshin testin me shkrim, testin e shkathtësive fizike, kontrollimin mjekësor; kontrollimin psikologjik; testin gojor; dhe hetimet mbi të kaluarën. Këto teste përdoren për të verifikuar se është përmbushur minimumi i standardeve të kërkuara me ligj.

#### **Neni 53**

##### **Trajnimi themelor i zyrtarëve policorë**

Kandidatët e përzgjedhur për pozitat e zyrtarëve policorë vijojnë trajnimin themelor të Policisë. Trajnimi duhet të jetë në përputhje me kërkesat e të gjitha standardeve minimale dhe programeve të përshkuara në nenin 50. Vetëm pas përfundimit me sukses të trajnimit themelor të Policisë i trajnuari do të certifikohet si zyrtar policor me të drejtën për të kryer detyra ekzekutive policore.

#### **Neni 54**

##### **Periudha provuese për zyrtarët policorë**

54.1 Pas përfundimit të trajnimit themelor për policë dhe certifikimit si zyrtar policorë, do të jetë një periudhë provuese e punësimit në kohëzgjatje prej së paku 6 muajsh gjatë së cilës zyrtari policor kryen detyra ekzekutive policore.

54.2 Nëse zyrtari policor e përfundon me sukses periudhën provuese, Policia do t'ia vazhdojë marrëdhënien e punës, ndërsa nëse performanca e zyrtarit policor është e pakënaqshme, Policia do t'ia ndërpresë marrëdhënien e punës pa të drejtë të kompensimit të mëtutjeshëm.

54.3 Zyrtari policor, të cilit i është ndërprerë marrëdhënia e punës, ka të drejtën e ankesës ashtu siç është e paraparë në ligj ose në aktin tjetër nënligjor.

**Neni 55**  
**Vlerësimi i punës së zyrtarit policor**

55.1 Policia, së paku një herë në vit, vlerëson punën e çdo zyrtari policor për ta vlerësuar efektivitetin e tij/saj në përmbushjen e kërkesave të shërbimit dhe të standardeve të domosdoshme profesionale gjatë kryerjes së detyrave policore.

55.2 Vlerësimi i punës për secilin zyrtar policor do të miratohet dhe do të nënshkruhet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë. Zyrtari policor duhet të informohet për rezultatin e vlerësimit.

**KREU VI**  
**MARRËDHËNIA E PUNËS**

**Neni 56**  
**Punësimi i personelit policor**

Policia e Republikës së Kosovës punëson dy kategori të personelit policor:

- a) zyrtarë policor që bëjnë betimin dhe kanë autoritet t'i ushtrojnë dhe t'i kryejnë autorizimet dhe detyrat policore;
- b) stafi civil që punësohet për të kryer shërbime mbështetëse dhe administrative, por që nuk ka autoritet të ushtrojë autorizime policore.

**Neni 57**  
**Zbatimi i Ligjit për Shërbimin Civil**

Për marrëdhënien e punës të të punësuarve në Polici zbatohet Ligji për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, përveç nëse është rregulluar ndryshe me këtë Ligj ose me ndonjë ligj tjetër në fuqi.

**Neni 58**  
**Gradat dhe funksionet e zyrtarëve policorë**

58.1 Sistemi i gradimit për zyrtarët policor është në përputhje me klasat dhe gradat vijuese:

- a) zyrtarët policorë të nivelit operativ:
  - i. zyrtari policor praktikant; dhe
  - ii. zyrtari policor;
- b) zyrtarët policorë të nivelit të parë të menaxhimit:
  - i. rreshteri policor;
- c) zyrtarët policorë të nivelit të mesëm të menaxhimit:
  - ii. togeri policor; dhe
  - iii. kapiteni policor;
- d) zyrtarët policorë të nivelit të lartë të menaxhimit:
  - i. majori policor;
  - ii. nënkoloneli policor; dhe
  - iii. koloneli policor.
- e) zyrtarët policorë të nivelit të lartë ekzekutiv të Policisë:
  - i. Ndhmësdrejtori Përgjithshëm i Policisë;
  - ii. Zëvendësdrejtori Përgjithshëm i Policisë; dhe
  - iii. Drejtori i Përgjithshëm i Policisë.

58.2 Gradat e nivelit të lartë ekzekutiv janë grada funksionale, ndërsa detyrat përmbushen nga zyrtari policor menjëherë pas emërimit në këtë pozitë. Pas përfundimit të periudhës së emërimit në pozitën e lartë ekzekutive, zyrtari policor rikthehet në gradën më të lartë në nivelin më të lartë të menaxhimit.

58.3 Gjatë trajnimit themelor të policisë, përfshirë trajnimin në Akademi dhe trajnimin fushor, i punësuari do ta ketë gradën e zyrtarit policor praktikant.

### **Neni 59** **Të drejtat e zyrtarëve policorë**

59.1 Zyrtarët policorë, gëzojnë të drejta të njëjta civile dhe politike sikurse qytetarët e tjerë, duke iu nënshtruar vetëm kufizimeve në këtë Ligj që janë të nevojshme për ushtrimin efektiv të autorizimeve dhe detyrave policore në shoqërinë demokratike.

59.2 Zyrtarët policorë gëzojnë të drejta të njëjta sociale dhe ekonomike sikurse shërbyesit e tjerë publikë, siç janë e drejta për të organizuar apo për të marrë pjesë në organizata përfaqësuese dhe t'i pranojnë shpërblimet e duhura, sigurimin social, ndihmën juridike, benificione shëndetësore dhe benificionet të tjera për punën e tyre.

59.3 Zyrtarët policorë nuk kanë të drejtë të bëjnë grevë, por kanë të drejtë t'i shprehin pakënaqësitë e tyre nëpërmjet protestave të organizuara dhe të udhëhequra nga organet përfaqësuese.

### **Neni 60** **Kompensimi dhe paga për zyrtarët policorë**

60.1 Kompensimi për zyrtarët policorë ka parasysh kushtet e veçanta nën të cilat ata i kryejnë detyrat e tyre. Paga themelore e zyrtarëve policorë ndryshon duke u bazuar në faktorët përfshirës, por jo të kufizohet vetëm me gradën dhe kohëzgjatjen e shërbimit.

60.2 Si shtesë e pagës themelore, zyrtarët policorë në mënyrë të ligjshme marrin lloje të shtesave, kompensime dhe benificione. Pagesat e tilla shtesë bazohen në faktorët duke përfshirë, por jo të kufizohen vetëm në detyrat e rrezikshme, punën jashtë orarit, orarin e punës me ndërrime, punën gjatë festave ose ditëve të tjera që janë ditë pushimi, caktimin në punë të veçanta dhe për shkathtësi të veçanta.

60.3 Shtesat përfshijnë, por nuk kufizohen në kompensime për punë të rrezikshme, kompensime për orar të punës me ndërrime, pagesa gjatë festave, pagesa për punë jashtë orarit, dhe pagesa për caktim në punë të veçantë. Benificionet mund të përfshijnë, por jo të kufizohen në, shpenzimet mjekësore dhe shëndetësore, shpenzimet për trajnimet profesionale dhe teknike, shpenzimet jetësore për transferim të përkohshëm, pushim me pagesë, kompensimet në rastet e vdekjes, stazhin e benificuar dhe benificionet e pensionit.

60.4 Pagat themelore dhe çdo shtesë e autorizuar përcaktohet dhe paguhet në përputhje me procedurat e përcaktuara në ligjin në fuqi dhe me aktet nënligjore. Drejtori i Përgjithshëm, me miratim të Ministrit mund të përfshijë në buxhetin vjetor të Policisë propozimin për shumat që nevojiten të përdoren për pagimin e çfarëdo pagese shtesë të autorizuar me ligj.

### **Neni 61** **Kompensimi për vdekje në kryerje të detyrës**

61.1 Policia paguan shpenzimet e ceremonisë së varrimit në Republikën e Kosovës për zyrtarin policor që vdes në kryerje të detyrës. Vendvarrimi do të caktohet nga anëtarët e familjes së zyrtarit policor. Policia do t'i paguajë vetëm shpenzimet në vijim:

- a) transportin për bartjen e kufomës deri te varrezat;
- b) shpenzimet e udhëtimit për dy persona shoqërues ;
- c) shpenzimet e funeralit që nuk janë paguar në forma të tjera;
- d) shpenzime e tjera me aprovimin e Ministrit.

61.2 Policia do të paguaj bashkëshortin apo fëmijët e mbijetuar nën moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeçare të zyrtarit policor i cili vdes në kryerje të detyrës një ndihmë financiare të menjëhershme në një shumë që është e barabartë me pagën mujore neto shumëzuar me gjashtë. Një pagesë e tillë do të bëhet vetëm pasi të përcaktohet se bashkëshorti apo fëmijët e mbijetuar kanë qenë të përkrahur nga zyrtari Policor para vdekjes së tij ose saj.

61.3 Bashkëshorti apo fëmijët e mbijetuar nën moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeçare të zyrtarit policor i cili vdes në kryerje të detyrës kanë të drejtë në pension familjar, por vetëm deri në vlerat dhe deri në nivelin e autorizuar me ligjin në fuqi dhe me aktet nënligjore të nxjerra nga Qeveria.

## **Neni 62** **Konflikti i interesave**

Zyrtari policor nuk do të pranojë një pozitë apo obligim, dhe nuk do të jetë pjesëmarrës në çfarëdo funksioni apo aktiviteti, i cili krijon konflikt të interesave me detyrat zyrtare të policisë. Pozitat dhe aktivitetet që formojnë konflikt të interesave përfshijnë por nuk kufizohen me:

- a) emërimi apo zgjedhja në detyrë publike apo pozitë tjetër qeveritare;
- b) pjesëmarrja në fushata elektorale për zgjedhje në detyrë publike;
- c) punësimi, apo pjesëmarrja në çfarëdo aktivitet biznesi për kompensim, përveç me leje të dhënë nga Drejtori i Përgjithshëm;
- d) pjesëmarrja aktive në cilëndo parti politike; ndjekja e udhëzimeve nga cilado parti politike në kryerjen e detyrave policore; paraqitja me uniformë policore në çfarëdo tubimi politik, përveç kur është në detyrë zyrtare policore (anëtarësimi i thjeshtë në një parti politike nuk është konflikt i interesave); dhe
- e) dhënia e deklaratave publike apo komenteve lidhur me punën e Policisë, përveç në raste kur lejohet nga eprori me autorizim të duhur.

## **Neni 63** **Transferimi i përkohshëm i zyrtarëve policorë tek autoritetet e ndryshme punëdhënëse**

63.1 Zyrtari policor do të transferohet përkohësisht tek një autoritet tjetër, duke përfshirë, por jo duke u kufizuar në, autoritete të administratës publike, apo institucion tjetër, për periudhë kohore jo më të gjatë se katër vjeçare.

63.2 Transferimi i përkohshëm do të lejohet vetëm me pëlqimin e zyrtarit policor. Gjatë transferimit të përkohshëm, zyrtari policor i mban gradat dhe të drejtat e tjera, përveç nëse është vendosur ndryshe.

## **Neni 64** **Caktimi i zyrtarit policor në detyrë jashtë Shtetit**

64.1 Zyrtari Policor mund të caktohet jashtë shtetit në detyrë si pjesë e punës së tij ose saj të rregullt në mënyrë që të mbështes bashkëpunimin me autoritet ndërkombëtare kompetente ose organizatat ndërkombëtare.

64.2 Caktimi në detyrë jashtë shtetit mund të bëhet vetëm me pëlqimin e zyrtarit policor.

64.3 Caktimi jashtë shtetit zbatohet vetëm ashtu siç parashihet në marrëveshjen e ligjshme ndërkombëtare, nënshkruese e së cilës është Republika e Kosovës.

## **Neni 65** **E drejta e ripunësimit të zyrtarit policor**

65.1 Zyrtari policor i cili jep dorëheqje nga Policia me qëndrim të mirë mund të ripunësohet në Polici pa konkurs, nëse ka ndonjë pozitë të lirë për të cilën ai është i kualifikuar.

65.2 Nëse ripunësimi bëhet pasi ka kaluar një (1) vit të pandërprerë, zyrtari policor vazhdon karrierën një gradë më ulët se ajo që ka mbajtur para shkarkimit ose ricertifkohet për gradën që mbante më parë.

65.3 Zyrtari policor i cili shkarkohet nga puna si rezultat i riorganizimit apo reduktimit të numrit të punëtorëve, dhe jo për ndonjë akuzë, mund të ri-punësohet nga Policia pa konkurs nëse ka ndonjë pozitë të lirë për të cilën ai është i kualifikuar.

## **Neni 66** **Komisioni i Policisë për Ankesa dhe Shpërblime**

66.1 Komisioni i Policisë për Ankesa themelohet nga Drejtori i Përgjithshëm për të shqyrtuar vendimet, veprimet apo mos veprimet nga Policia që kanë të bëjnë me statusin e zyrtarit policor në përputhje me këtë ligj.

66.2 Shqyrtimi i vendimit mund të kërkohej nga zyrtari policor i cili ndihet i dëmtuar nga vendimi, veprimi, apo mos veprimi, ose nga autoriteti policor në të cilin zyrtari policor është i punësuar.

## **KREU VII FINANCIMI**

### **Neni 67 Buxheti i Policisë dhe Menaxhimi Financiar**

67.1 Policia do të ketë buxhetin e saj, i cili është buxhet i ndarë në kuadër të Ministrisë, të miratuar nga Kuvendi.

67.2 Drejtori i Përgjithshëm përgatitë buxhetin e Policisë, të cilin pastaj ia përcjell Ministrit për shqyrtim dhe procedim të mëtutjeshëm në përputhshmëri me procedurat e parapara me ligj.

67.3 Policia do të jetë përgjegjëse për implementimin dhe menaxhimin e buxhetit.

### **Neni 68 Fondet e veçanta të Policisë**

68.1 Buxheti i Policisë duhet ta ketë një shumë të caktuar për fonde të veçanta për tu përdorur për pagimin e shpërblimeve, pagimin e informatorëve, pagimin për mbrojtjen e dëshmitarëve, dhe pagimin e operacioneve e tjera të veçanta policore.

68.2 Fondet e përshkruara në paragrafin 1 të këtij neni do të administrohen nga Drejtori i Përgjithshëm në pajtim me aktet nënligjore të nxjerra nga Ministri për udhëheqjen, menaxhimin dhe shpenzimin e fondeve të tilla.

### **Neni 69 Përgjegjësia për dëmin ose lëndimin**

69.1 Zyrtari policor raporton tek mbikëqyrësi i tij apo saj çdo dëm apo lëndim që ai apo ajo ka shkaktuar gjatë kryerjes së detyrave policore të tij/ saj.

69.2 Në përputhje me ligjin në fuqi, Qeveria e Republikës së Kosovës do të jetë përgjegjëse për dëmet apo lëndimet e shkaktuara personave fizikë ose juridikë si rezultat i veprimeve të zyrtarëve policorë në kryerjen apo në ndërlikime me kryerjen e detyrave policore.

### **Neni 70 Medaljet, lëvdatat, shpërblimet dhe mirënjohjet**

70.1 Ministri dhe Drejtori i Përgjithshëm janë të autorizuar t'u japin medalje, lëvdata, shpërblime dhe mirënjohje, zyrtarëve policorë, punëtorëve të tjerë të Policisë, personave fizikë dhe juridikë të vendit dhe të huaj që e kanë dalluar vetën me meritat e tyre.

70.2 Ministri jep medaljet në vijim:

- a) medaljen e Nderit;
- b) medaljen për Merita;
- c) medaljen për trimëri; dhe
- d) medaljen e Shpëtimit të Jetës.

70.3 Drejtori i Përgjithshëm jep medaljet në vijim:

- a) medaljen Mburojë e Policisë;

- b) medaljen për Shërbim të Dalluar,
- c) medaljen Policore për Lavdim; dhe,
- d) medaljen për Shërbim Besnikërisë.

## **KREU VIII DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE**

### **Neni 71**

#### **Transferimi i funksioneve, stafit, pasurisë dhe të dhënave nga Shërbimi Policor i Republikës së Kosovës**

71.1 Detyrat, përgjegjësitë dhe funksionet e Shërbimit Policor të Republikës së Kosovës të themeluara sipas autoritetit të Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (në tekstin e mëtejshëm "UNMIK"), nëpërmjet Rregulloreve të UNMIK-ut i transferohen Policisë së Republikës së Kosovës dhe të njëjtat do të përmbushen në pajtim me dispozitat e këtij Ligji. Ky transferim i funksioneve nuk do të ketë efekt në hetimet ose ndjekjet të cilat janë në procedurë e sipër.

71.2 Të gjithë zyrtarët dhe punonjësit e tjerë të Shërbimit Policor të Republikës së Kosovës të themeluar sipas autoritetit të UNMIK-ut përmes Rregulloreve të UNMIK-ut i transferohen Policisë së Republikës së Kosovës të themeluar me këtë Ligj.

71.3 Të drejtat dhe obligimet kontraktuese të zyrtarëve policorë dhe punonjësve të tjerë, duke përfshirë, por nuk kufizohet vetëm me gradat dhe të drejtat nga përvoja, do të vazhdojnë sikur të mos ketë pasur ndryshim të punëdhënësi. Gradat ekzistuese, të drejtat dhe obligimet rregullohen me këtë Ligj.

71.4 Të gjitha të drejtat, obligimet, kontratat, pasuria, buxheti dhe përgjegjësitë e Shërbimit Policor të Republikës së Kosovës të themeluar sipas autoritetit të UNMIK-ut nëpërmjet Rregulloreve të UNMIK-ut i transferohen Policisë së Republikës së Kosovës të themeluar në pajtim me këtë Ligj. Policia do të ketë të drejta të njëjta pronësore dhe kontraktues sikurse edhe Shërbimi Policor i Republikës së Kosovës në kohën e transferimit.

71.5 Të gjitha librat dhe të dhënat e Shërbimit Policor të Republikës së Kosovës të themeluar sipas autoritetit të UNMIK-ut përmes Rregulloreve të UNMIK-ut i transferohen dhe të njëjta bëhen libra dhe të dhëna të Policisë së Republikës së Kosovës të themeluar me këtë Ligj.

71.6 Të gjitha transferimet e përshkruara në këtë nen bëhen efektive në ditën e hyrjes në fuqi të këtij Ligji.

### **Neni 72**

#### **Kalimi në strukturën e re të gradave**

Drejtori i Përgjithshëm, me aprovimin e Ministrit, do të nxjerrë akte nënligjore për ta sqaruar kalimin e zyrtarëve policorë nga sistemi i mëparshëm i gradave në sistemin e gradave të përcaktuara me këtë Ligj.

### **Neni 73**

#### **Nxjerrja e akteve nënligjore**

73.1 Drejtori i Përgjithshëm me Udhëzim Administrativ me hollësisht do ta rregulloj:

- a) mënyrën e ofrimit të ndihmës organeve qeveritare, siç përshkruhet në nenet 7, 8 dhe 9 të këtij Ligji;
- b) mënyrën e kryerjes së detyrave dhe autorizimeve policore siç përshkruhet në nenet 10 dhe 11 të këtij Ligji;
- c) përdorimin e forcës nga zyrtarët Policor siç përshkruhet në nenin 25 të këtij Ligji;
- d) përdorimin e armëve të zjarrit nga Zyrtarët Policor siç përshkruhet në nenin 26 të këtij Ligji;
- e) standardet dhe metodat për mbledhjen, ruajtjen, përdorimin dhe fshirjen e të dhënave personale të mbajtura nga Policia siç përshkruhet në nenin 30 të këtij Ligji;

- f) kualifikimet e nevojshme dhe angazhimi i Policisë rezervë siç përshkruhet në nenin 36 të këtij Ligji;
- g) procedura, notimi dhe kriteret për vlerësimin e punës për zyrtarët policor siç përshkruhet në nenin 55 të këtij Ligji;
- h) procedura e gradimit për zyrtarët policor dhe gradat për funksione të veçanta administrative, shkencore dhe teknike siç përshkruhet në nenin 55 të këtij Ligji;
- i) procedura e ripunësimit siç përshkruhet në nenin 65 të këtij Ligji;
- j) llojet e Lëvdatave, Shpërblimeve dhe Mirënjohjeve siç përshkruhet në nenin 70 të këtij Ligji; dhe
- k) drejtori i Përgjithshëm do të nxjerr akte nënligjore me qëllim përkrahjes së bashkëpunimit në mes të kuvendit komunal dhe komunitetit në pajtim me këtë nen, dhe do të përkrahë funksionalitetin e plotë të Komiteteve për Siguri dhe Bordeve.

73.2 Ministri me akt nënligjor do të rregullojë:

- a) llojet e veprave të lehta dhe të rënda disiplinore;
- b) aktet nënligjore që kanë të bëjnë me menaxhimin dhe shpenzimin e fondeve të veçanta policore; dhe
- c) kriteret dhe procedurat e dhënies së medaljeve shpërblyese të përshkruara në nenin 70 të këtij Ligji.

#### **Neni 74 Shfuqizimi**

Ky Ligj shfuqizon të gjitha dispozitat e ligjit në fuqi që janë në kundërshtim me këtë ligj në kohën e hyrjes së tij në fuqi, përveç në rastet ku ky Ligj në mënyrë specifike e njeh autoritetin e ligjit tjetër.

#### **Neni 75 Data e hyrjes në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë ( 15 ) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës**

**Me datën : 20.02.2008**